



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 17.09.2013
Nr. 07.1180

PËR: Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë

LËNDA: Shkresë përcjellëse - Zbatimi i Vendimeve të KPMK

I nderuari Kryetar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), më datën 05.09.2013 ka pranuar ankesë nga z. Mustafe Aliu nga fshati Drobesh, si dhe Muhamet Osmani nga fshati Smire Komuna e Vitisë me të cilën kërkojnë nga MAPL, ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK) nga ana e Komunës së Vitisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ankesave në fjalë konstaton se:

- Vendimet e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës Nr.02 (14) 2009, si dhe 02 (16) 2009 janë përfundimtare në procedurë administrative dhe si të tilla duhet të zbatohen ashtu siç është paraparë me nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ekzekutimi i vendimit duhet të bëhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit.
- Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është ligjshëm, kundër vendimit të Këshillit mundë të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente në aftë prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar nga ajo që u tha më lartë MAPL kërkon nga autoritetet e komunës përkatësisht nga Kryetari i Komunës, të ndërmarrin veprime të cilat ndikojnë në zbatimin e vendimeve të lartshënuara.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL;
Mustaf Aliu, fshati Drobesh – Komuna e Vitisë
Muhamet Osmanin fshati Smire – Komuna e Vitisë
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së;
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 17.09.2013

Nr. 07.1180

Za: Nexhmedin Arifi, Gradonačelnik Opštine Vitina

Predmet: Propratni dopis - Sprovođenje odluka NSNK

Poštovani gradonačelnice ,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave (MALS), dana 05.09.2013 je primila žalbu od g. Mustafe Aliu iz sela Drobeš, kao i Muhamet Osmani iz sela Smira Opština Vitina sa kojom traže od MALS,preduzimanje mera za spovodjenje odluka Nezavisnog Saveta Nadgledavanja Kosova (NSNK) od strane Opštine Vitina.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave,u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII të Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja navedenih žalbi konstatuje:

- Odluke Nazvisnog Odbora Nadgledavanja br.02 (14) 2009, kao i 02 (16) 2009 su završni u administrativnoj proceduri i kao takvi se spovode onako kako je predvidjeno sa članom 13 Zakona br. 03/L-192 za Nezvisni Savet Nagledavanja za Civilnu službu Kosova. Izvršenje odluke treba da se uradi u roku od petnaest (15) dana od prijema odluke.
- Nezadovoljna strana koja misli da Odluka Saveta nije zakonita,protiv Odluke Saveta može da inicira administrativni konflikt u nadležnom sudu u roku od(30) dana, od dana kada je predata odluka. Iniciranje administrativnog konflikta ne zadržava izvršenje odluke Saveta.

Na osnovu gore iznetog MALS-a traži od opštinskog autoriteta odnosno od Gradonačelnika Opštine,da preduzme mere koje utiču na spovodjenju gore navadenih odluka.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera &Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani,Generalni Sekretar MALS-a;
Mustaf Aliu, selo Drobeš – Opština Vitina
Muhamet Osmanin selo Smira – Opština Vitina
Rukovodiocima Uprava MALS-a;
Arhivi MALS-a.

Kumbi 06.09.2013

MINISTRISË SE ADMINISTRIMIT TE PUSHTETIT LOKAL

Lenda:

ANKESE

HYRËSE-ULAZNA-INGOMING REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA DEVERIA E KOSOVES YLADY KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum 05.09.2013 Date			
Nivisa organizative	Nr i Lendës	Shtojca	Vlera
- III -	07-1180	2	

Per implementimin e Vendimit te Kshillit te Pavarur Mbikqyres te Kosoves;

Me kete shkrese i drejtohem i MAPL-se per te kerkuar perfshirjen e Juaj ne imlementimin e ketij Vendimi i cili po referohet te implementohet nga Kryetari i Komunes se Vitise.

Te bashkangjitura:

- 1.Vendimi i KPM-se
- 2.Rekomandimin e MASHT-it;
- 3.Perfundimin-Rekomandimin e Kuvendit te Republikes se Kosoves.

Viti me 05.09.2013

Parashtruesi i ankeses;

/Mustafe Aliu /
Drobesh -Viti

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVO			
Dorezuar Predato Delivered	06.03 2009	viti year	2009
Organ/njësia Organ./Unit Org. / Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:	Shënimi Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMK	475/09		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština - Assembly

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD

Nr.02 (14) 2009

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës-Komisioni i përbërë nga: Mr.Sc. Flora Balidemaj-Hoxha, kryetare dhe Bajram Ajeti e Mehdi Geci anëtarë, në çështjen juridike të shqyrtimit të ankesës së Mustafë Aliut nga Vitia, si Shërbyes Civil, të parashtruar përmes përfaqësuesit av.Naim Haliti, dhe KK.Viti si Autoritet Punëdhënës, kundër Vendimit të Drejtorit të DKA-së, në KK.Viti, nr. 03-118/5056, datë 12.11.2008, (për ndërprerjen e marrëdhënies së punës), pas shqyrtimit gjithëpërfshirës të provave të ofruara, në seancën jopublike, në përputhje me dispozitat e nenit 11 par.11.2 pika (a) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 36/2001, mbi Shërbimin Civil të Kosovës, të ndryshuar me Rreg.nr.2008/18, lidhur me nenin 2 par.2.1 të Rregullores së Punës së KPMK-së, nr. 2008/2, mbi Rregullat dhe Procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, me datën 6.3.2009, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET ankesa nr. 02(14)2009 e datës 29.1.2009 e ankuesit Mustafë Aliu, e ushtruar përmes përfaqësuesit të tij av.Naim Haliti si e bazuar dhe

II. ANULOHET Vendimi i Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në KK.Viti, nr. 03-118/5056, datë 12.11.2008, (për ndërprerjen e marrëdhënies së punës),

III. OBLIGOHET -Organi i punësimi që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, ankuesit t'ia mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës, në përputhje me kontratën e punës të datës 4.8.2006.

IV. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Kryetari i Komunës dhe Drejtori për Administratë dhe Personel i KK. Vitisë.

V.Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi, të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.

VI. Në rast mosveprimi sipas këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, do të njoftojë Kuvendin e Kosovës, i cili ia përcjellë raportin Kryeministrit të Kosovës në përputhje me nenin 11 par. 11.4 të Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës e ndryshuar me Rregulloren nr. 2008/12.

Arsyetim

Z.Mustafë Aliu ka qenë i punësuar në Shkollën Fillore "Faik Konica" në Viti-Drejtor i Shkollës me kontratë të punës të datës 4.8.2006, lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Me Vendimin 03-118/5056, datë 12.11.2008, Drejtori i DKA-së, në KK.Viti, Mustafë Aliut i ka ndërprerë marrëdhënien e punës, me arsyetim se atij edhe më parë i janë shqiptuar masa disiplinore të vërejtjes me gojë, vërejtjes me shkrim, dhe një vëretje e fundit me shkrim, masa këto që nuk kanë ndikuar në përmirësimin e tij.

Kundër këtij vendimi, z. Aliu ka paraqitur ankesë në Komisionin e Ankesave të KK. në Viti por, nga shkresat e lëndës rezulton se deri më tash ky Komision nuk e ka shqyrtuar ankesën në fjalë.

Pas kalimit të afatit ligjor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, për vendosje nga Komisioni i Ankesave brenda Autoritetit Punëdhënës z. Mustafë Aliu përmes përfaqësuesit të tij av.Naim Halitit, me datën 29.1.2009, i është drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, me të cilën ka propozuar që KPMK, të aprovojë ankesën e tij, të anulojë vendimin e kundërshtuar dhe të detyrojë KK.Viti, që ankuesit t'i njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e tij të punës.

Komisioni i KPMK-së, kompetent për shqyrtimin e kësaj çështjeje, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje, administroi këto prova relevante: Aktvendimin e Drejtorit të DKA-së, në KK.Viti, nr. 05-115/08, datë 14.5.2008, për shqiptimin e masës disiplinore të 'vërejtjes me shkrim', ndaj z. Mustafë Aliu, Aktvendimin e dytë të Drejtorit të DKA-së, në KK.Viti, nr. 05-207/08, datë 11.9.2008, për shqiptimin e masës disiplinore të 'vërejtjes së fundit me shkrim', Raportin e Zyrtarëve të DKA-së, në KK.Viti, mbi vizitën e këtyre zyrtarëve në Shkollën Fillore "Faik Konica" në Viti, të datës 2.10.2008, Vendimin e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim e Kulturë nr.03-118/5056 të datës 12.11.2008 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Ankesën drejtuar Komisionit të ankesave të KK-Viti nr.03-07/5148 e datës 17.11.2008 dhe Përgjigjen në ankesë nga Organi i Punësimit nr.174/09 të datës 11.02.2009.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave ankimore të ankuesit dhe përgjigjes në ankesë të Autoritetit Punëdhënës me provat e shkresat e bashkangjitura nga ta, Komisioni i KPMK-së, gjeti se,

ankesa është e bazuar

Nga shkresat e kësaj lënde del se, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës të Komunës së Vitisë, me Vendimin nr. 03-118/5056 të datës 12.11.2008, z. Mustafë Aliut i ka ndërprerë kontratën e punës të datës 4.8.2006, (me kohëzgjatje kohore prej datës 7.8.2006, deri më 7.8.2009), në kundërshtim me dispozitat ligjore të parapara me nenin 31 par.31.1, 31.2 dhe 31.4, pastaj nenin 32 par.32.1 dhe 32.4, të UA.nr.2003/2, mbi zbatimin e Rreg.nr.2001/36, mbi Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilat është përcaktuar qartë se: kur një shërbyes civil dyshohet apo akuzohet se ka bërë shkelje disiplinore në kundërshtim me Kodin e mirësjelljes, rasti me fakte duhet t'i raportohet Udhëheqësit Kadrovik, (menaxherit të personelit), (neni 31 parag.31.1), i cili e heton shkeljen se, a është kryer dhe a është e lehtë apo serioze (neni 31 parag.31.2), derisa edhe masën disiplinore për shkelje të lehta me vërejtje me gojë dhe me shkrim e shqipton Menaxheri i personelit dhe futet në dosje personale të shkelësit (neni 31 parag.31.4).

Në çështjen konkrete, masat e shqiptuara disiplinore "vërejtje me shkrim", ndaj ankuesit, nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim e Kulturë janë marrë në kundërshtim edhe me nenin 32 par. 32.4 të UA.nr.2003/2, mbi Zbatimin e Rreg.nr.2001/36, mbi Shërbimin Civil të Kosovës, sepse kjo e drejtë është funksion i Komisionit Disiplinor, që të dëgjojë dëshminë për shkeljen e supozuar, të vendosë se në bazë të dëshmive të ofruara është kryer apo jo një shkelje dhe është Komisioni Disiplinor ai që përcakton dënimin apo masën që duhet shqiptuar, e jo Drejtori i DKA-së, siç është vepruar në çështjen konkrete.

Me nenin 35 parag. 35.1 dhe 35.2 të Urdhëresës Administrative nr.2003/2 mbi zbatimin e Rregullores nr.2001/36 është e përcaktuar poashtu se, marrëdhënia e punës mund t'i përfundojë shërbyesit civil me rastin e vdekjes, pas skadimit të kontratës, dorëheqjes dhe kur nuk kalon periudhën provuese (neni 35 parag.35.1), e gjithashtu marrëdhënia e punës përfundon nëse ndaj shërbyesit civil është shqiptuar ndonjë masë disiplinore për shkelje të rëndë të Kodit të Mirësjelljes.

Vendimi i Drejtorit të DKA-së, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së z. Aliu është në kundërshtim edhe me hapin 2 nën 2e pika 2e 1.4 të UA/MSHP/DASHC.nr.2003/6, mbi Procedurat e Ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ku thuhet se mund të përfundojë marrëdhënia e punës "me rekomandimin e Komisionit të Mirësjelljes dhe Disiplinës ose të Ankesave" dhe nenin 2 parag.2g të të njëjtit Udhëzim se, "Kontrata e marrëdhënies së punës mund të ndërprehet pas rekomandimit nga Komisioni disiplinor ose i ankesave".

Duke pasur parasysh faktin se, Autoriteti Punëdhënës nuk ka iniciuar asnjë procedurë disiplinore dhe ankuesit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore sipas procedurave dhe ligjit e cila do të ishte bazë për përfundimin e Kontratës së punës, Komisioni i KPMK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Vendimi i këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin.

T'i dorëzohet: Ankuesit Z. Mustafë Aliu,
KK- Viti - Drejtorit për Administratë dhe Personel,
Menaxherit të Personelit,
Drejtorit të Arsimit dhe Kulturës dhe
Dosjes së lëndës ankimore.


Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
Lënda nr. 02 (14) 09, më 6.3.2009.

Komisioni i KPMK-së

Mr.Sc.Florë Balidemaj-Hoxha, Kryetare

Bajram Ajeti, anëtar

Mehdi Geci, anëtar



Shkencë

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARSIMIT-SEKTOR ARBIVE ARSIME SE TIR	
Nr. Prot. D/1. Jentimca D/1. Cind. Nr. Tregues D/Stranica No. pages	Nr. Prot. D/1. Jentimca D/1. Cind. Nr. Tregues D/Stranica No. pages
2-14 2	3782 20.08.2013 Prishtine /a



23 08 2013

[Handwritten signature]

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/ Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 3782/2-14
Dt. 20.08.2013

Komisioni për ankesa dhe zgjidhjen e kontesteve i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në mbështetje të nenit 82 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

REKOMANDIM

Rekomandohet Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti, ta zbatoj vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikqyrës nr.02/14/2009 dt.06.03.2009.

Arsyetimi

Mustaf Aliu nga Vitia ka parashtruar ankesën me nr.prot. 3782 dt. 19.07.2013 kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti, për shkak të moszbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës nr. 02/14/2009 me të cilin obligohet DKA ta kthej në vendin e punës.

Komisioni lexoj vendimin e KPMK nr.02/14/2009, Rekomandimin e Komisionit për Administratë publike, Pushtet Lokal dhe Media të dt. 27.01.2010, me të cilin i drejtohet

skelen

4 Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me mosekzekutimin e vendimit të KPMK ,Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.03-P-189 dt.08.02.2010 dhe sipas parashtruesit të ankesës edhe pse kanë kaluar afër 4 vite ky vendim ende nuk është zbatuar ,prandaj Komisioni për ankesa dhe zgjidhjen e kontesteve pas leximit dhe shqyrtimit të provave të cekura, vendosi të rekomandoj Drejtorinë Komunale të Arsimit në Viti ,ta zbatoj vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikqyrës nr.02/14/2009.

Vendimi u dërgohet:

1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti;
2. Mustaf Aliu-Viti
3. Arkivit.



Avni Rexha, kryetar i komisionit

24-08-2013

